



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

RAPORTI VJETOR (Janar-Dhjetor 2015)

PËR

**PARANDALIMIN E EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIN E PARAVE,
FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE KRIMEVE FINANCIARE NË KOSOVË
(2014-2018)**

Nëntor 2016, Prishtinë

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	5
2. HYRJA.....	8
3. OBJEKTIVI, METODOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET	9
3.1. Objektivi.....	9
3.2. Metodologjia	9
3.2.1. Kontribuesit	9
3.2.2. Metodatat direkte	10
3.2.3. Metodatat indirekte	10
3.3. Përkufizimet	9
4. ANALIZA DHE GJETJET PËR PARANDALIMIN E EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE DHE FINANCIARE.....	11
4.1. Zhvillimi i regjimit për luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar në Kosovë.....	11
4.2. Implementimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018	12
4.2.1. Krijimi i mekanizmave për implementim dhe mbikëqyrje	12
4.2.2. Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit 2014-2018 dhe statusi i implementimit të tyre.....	14
4.2.3. Gjetjet	17
4.3. Rezultatet Operative në Parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe financiare 2010-2015	18
4.3.1. Parandalimi i ekonomisë joformale	18
4.3.2. Procedura penale për pastrim të parave, financim të terrorizmit, krimeve ekonomike dhe financiare	20
4.3.3. Gjetjet	23
4.4. Rezultatet operative të parandalimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare dhe ekonomike në periudhën ndërmjet janarit dhe dhjetor 2015.	23
4.4.1. Objektivat operative të përcaktuara në Plan Veprimin e Strategjisë Kombëtare 2014 - 2018.....	23
4.4.2. Parandalimi i ekonomisë joformale	24
4.4.3. Procedura penale për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe financiare	25
4.4.4. Gjetjet	30
5. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET NË LIDHJE ME PARANDALIMIN E EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT SI DHE KRIMEVE EKONOMIKE DHE FINANCIARE	33
5.1. Implementimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018	33
5.1.1. Konkluzionet dhe rekomandimet	33
5.2. Performanca operative.....	34
5.2.1. Konkluzionet dhe rekomandimet	34

LISTA E TABELAVE

1. Llojet e të hyrave në buxhetin e Qeverisë së Kosovës 2011-2015 në miliona
2. Vlera e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve dhe taksave doganore dhe akcizës të prapambetur 2015
3. Rezultatet Operative të NjIF-K 2015
4. Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2008-2015
5. Vlera e fondeve të sekuestruara dhe konfiskuara nën menaxhimin e Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar 2008-2015
6. Vlera e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve, taksave doganore dhe të hyrave tjera, janar- dhjetor 2015 dhe 2014
7. Vlera e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve, taksave doganore dhe të akcizës së prapambetur, janar- dhjetor 2015 dhe 2014
8. Rezultatet Operative te NjIF-K ne 2015
9. Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, janar- dhjetor 2015
10. Krimet financiare të proceduara për ngritje të padive nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, janar- dhjetor 2015
11. Vlera neto e pasurisë së sekuestruar gjatë hetimeve të Policisë së Kosovës, Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore, janar- dhjetor 2015
12. Dënimet e krimeve financiare nga Gjykatat themelore, janar- dhjetor 2015
13. Vlera totale e vendimeve për konfiskim nga Gjykatat Themelore, janar- dhjetor 2015
14. Vlera e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar nën menaxhimin e Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, janar- dhjetor 2015

LISTA E GRAFIKONEVE

1. Grafiku i procesit të implementimit dhe mbikëqyrjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018

LISTA E SHTOJCAVE

1. Instrumenti i Monitorimit dhe Rishikimit për Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Historiku

Ekonomia joformale, krimet financiare dhe ekonomike, përfshirë këtu edhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe korrupsioni, janë faktorë të cilët shkaktajnë dëme serioze në ekonominë dhe ndikojnë negativisht në mirëqenien e shoqërisë në tërësi. Këto fenomene të dëmshme ndryshojnë në natyrë dhe shtrirje, varësisht zhvillimeve ekonomike, prandaj, është e rëndësishme që kontribuesve dhe opinionit si tërësi të ju ofrohen informata të sakta dhe gjithëpërfshirëse me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit të tyre dhe informimit për ndërmarrjen e politikës parandaluese nga niveli më i lartë institucional.

Qeveria e Republikës së Kosovës e cila me aprovimin e Strategjinë kombëtare dhe Planin e veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018 (më tutje referuar si Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018), ka ndërmarrë veprime për implementimin e planit të veprimit të cilat kanë pasur efekte pozitive në ekonomi. Strategjia dhe plani i veprimit janë të bazuara në të gjeturat e raportit mbi vlerësimin e riskut nacional ku janë identifikuar gjashtë objektiva kryesore, siç janë:

1. Ngritja e vetëdijes për ndikimet në ekonominë joformale dhe krimeve financiare
2. Forcimin e parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mire dhe partneritetin social
3. Promovimi i procedurave të inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare
4. Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Relevante
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizimit dhe krimeve financiare
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas

Për trajtimin e këtyre objektivave është hartuar plani i veprimit fillimisht me 51 aktivitete të cilat janë në proces të implementimit. Në mesin e 51 aktiviteteve, aktiviteti 2.1.1 i Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018, kërkon që të hartohen Raportet e gjendjes, të bazuara në fakte, me fokus në ekonominë joformale dhe krimin financiar në Kosovë, në baza të rregullta 6 mujore, për të mbështetur institucionet relevante jo vetëm në planifikimin strategjik dhe operativ, por po ashtu edhe në ngritjen e vetëdijes në shoqëri nëpërmjet komunikimit.

Raporti vjetorë 04/2015 për Parandalimin e Ekonomisë Joformale dhe Krimeve Financiare në Kosovë mbulon aktivitetet e zhvilluara dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës kohore 01.01.-31.12.2015.

Metodologjitë

Sekretariati¹ ka hartuar Raportin e gjendjes 1/2014, 2/2014, raportin vjetorë 03/2014 dhe raportin vjetor 04/2015 duke përdorur metodat direkte dhe indirekte, duke i kushtuar vëmendje kritereve subjektive dhe objektive. Raporti vjetorë i Gjendjes 03/2014 është miratuar nga Grupi Punues Qeveritar².

Metodat direkte kanë përfshirë intervista dhe takime që ka pasur për objektiv marrjen e informatave lidhur me kriteret subjektive si nga niveli operativ po ashtu edhe nga ai menaxherial të organizatave që përfaqësojnë sektorët publikë, privatë dhe ata të tretë.

Metodat indirekte kanë përfshirë analizat e raporteve të mëparshme të vlerësimit dhe analizave, statistikave dhe kornizës ligjore. Qëllimi ishte të merren informata lidhur me kriteret objektive.

Në këtë Raport vjetor të gjendjes 04/2015, Sekretariati ka: mbledhur informata, kryer një analizë, përgatitur gjetjet, nxjerrë konkluzione dhe ka paraqitur një sërë rekomandimesh.

Analizat dhe gjetjet

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Në lidhje me implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018, gjatë vitit 2015 institucionet përgjegjëse kanë përfunduar 4 aktivitetet, ndërsa (5) aktivitetet është në proces të implementimit. Aktivitetet tjera ende nuk kanë filluar së implementuar. Duhet theksuar që progresi i arritur në implementimin e Strategjisë ka qenë i jashtëzakonshëm, dhe nga fillimi i implementimit të Planit të Veprimit në vitin 2014, Sekretariati ka arritur të realizojë rreth 76% të aktiviteteve të PV, duke përfunduar kështu në tërësi 2 objektiva (Objektiven 1 dhe Objektiva 3) nga 6 objektiva sa ishin në total.

Strategjia Kombëtare 2014-2018 përfshin një Instrument për monitorim dhe rishikim, si një shtojcë, që kërkon institucionet përgjegjëse që rezultatet e procesit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 duhet të raportohen në baza të rregullta duke përdorur instrumentin “Monitorimi dhe Rishikimit i aktiviteteve” i cili është përfshirë në Raportin Vjetor të Gjendjes nr. 04/2015 si Shtojca 2.

Gjate implementimit të aktiviteteve, Sekretariati në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, ka identifikuar dobësitë të cilat përbëjnë rrezik për implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të

¹Sekretariati është themeluar dhe udhëhiqet nga Ministria e Financave duke u bazuar në Strategjinë kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Detyrat e tij janë mbështetja e Qeverisë, përmes Grupit punues qeveritar, në hartimin, rishikimin, ndryshimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

² Ibid.

veprimit 2014-2018. Këto dobësi kryesisht janë të ndërlidhura me objektivat strategjike të Planit të Veprimit (2 dhe 5) si në vijim:

- Objektiva 2: Forcimin e kapaciteteve të institucioneve përkatëse; dhe
- Objektiva 5: Zhvillimi dhe aplikimi i një çasje pro aktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e veprimit 2014-2018, gjatë periudhës raportuese, Ministria e Financave, nëpërmjet Sekretariatit, ka vazhduar të pranoj informata në lidhje me rezultatet operative të organeve administrative, ato të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit. Sekretariati ka analizuar të dhënat për periudhën e raportimit Janar-Dhjetor 2015, të dhëna këto që kanë për qëllim përcjelljen e aktiviteteve në parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurën penale të krimeve financiare. Që nga fillimi i implementimit të Strategjisë në vitin 2014, shihet se rezultatet operative të autoriteteve përkatëse kanë pasur një zhvillim pozitiv, por që ende ekzistojnë disa dobësi të caktuara të cilat përbëjnë rreziqe për efikasitet dhe transparencë. Fazat më sfiduese të procesit janë prokuroria si dhe përdorimi i aktgjykimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim. Kjo është si rezultat i informatave jo të plota dhe jo konsistence për performancën e institucioneve.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Me qëllim të parandalimit të realizimit të rreziqeve strategjike dhe operative, Sekretariati ka nxjerrë konkluzione dhe rekomandime për Qeverinë. Ato fokusohen në këto fusha:

1. Në përputhje me Shtojcën 1 të aktivitetit 2.4.1 të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018, duhet vazhduar së siguruari Sekretariatit informata 6-mujore në lidhje me performancën operative dhe rezultatet e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e ekonomisë joformale dhe të procedurës penale për krimet financiare;
2. Në përputhje me aktivitetin 2.4.11 të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018, për bërjen e vlerësimit të nevojave për trajnim të Përbashkët, Strategjinë dhe Programin për sektorin publik, privat dhe të tretë në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e ekonomisë joformale, dhe krijimin e programit trajnues kualitativ nga PK, kërkohet definimi dhe alokimi i buxhetit prej 30,000 EUR për implementimin e Programit të trajnimeve për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare;
3. Të sigurohet që buxheti qeveritar për vitin financiar 2016 e tutje të përfshijë objektivat e nivelit kombëtar përkitazi me parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurën penale për krimet financiare për institucionet përgjegjëse administrative, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësore; dhe
4. Të sigurohet që institucionet përgjegjëse administrative, zbatimit të ligjit dhe gjyqësore për parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurën penale për krimet financiare të përgatisin plane të performancës për vitin financiar 2016 e tutje, duke përfshirë objektiva të qarta në nivel institucional, masat e tyre të implementimit si dhe indikatorët kyç të performancës në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurën penale për krimet financiare. Objektivat e planeve të performancës në nivel institucional duhet të dalin nga qëllimet e buxhetit të Qeverisë.

2. HYRJA

Hartimi i Raportit vjetor të gjendjes nr. 04/2015 është i bazuar në aktivitetin 2.1.1 të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Këto dokumente të politikave janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës me 28.01.2014.

Objektivat e Raportit vjetorë të gjendjes nr.04/2015 janë si në vijim:

- Mbështetja e institucioneve relevante të sektorit publik, privat dhe të tretë në planifikimin dhe vendim-marrjen strategjike dhe operative;
- Të sigurojë informata në lidhje me fushat e fokusit të vlerësimeve specifike të rrezikut, sondazheve, hulumtimeve dhe studimeve për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar;
- Rritja e komunikimit dhe ndërëgjegjësimit në mesin e shoqërisë për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar;
- Sigurimi i informatave të bazuara në fakte për organizatat ndërkombëtare dhe mediat në lidhje me ekonominë joformale dhe krimeve financiare në Kosovë, si dhe mekanizmave parandaluese në dispozicion.

Raporti vjetor i gjendjes, i cili hartohet çdo vit, përmban informata të agreguara të raporteve gjysmë-vjetore në lidhje me statusin e implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018. Rezultatet e zbatimit të procesit janë të përcaktuara në Instrumentin për Monitorim dhe Rishikim e cila është e përfshirë në Raportin vjetor 04/2015 si Shtojca 1.

Raporti gjithashtu përmban informacione mbi situatën dhe zhvillimet aktuale sa i përket performancës operative dhe rezultatet në parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar në bazë të objektivave dhe treguesve kyç të performancës të përcaktuara në Shtojcën 1 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018.

Raporti i të gjeturave në parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar në Kosovë është hartuar nga Sekretariati³ i cili është themeluar nga Ministria e Financave, i cili raport është miratuar nga Grupi Punues Qeveritar⁴. Raporti i vjetorë i gjendjes 04/ 2015 mbulon aktivitetet e zhvilluara dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës kohore 1.1.-31.12.2015.

³Sekretariati është themeluar dhe udhëhiqet nga Ministria e Financave duke u bazuar në Strategjinë kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Detyrat e tij janë mbështetja e Qeverisë, përmes Grupit punues qeveritar, në hartimin, rishikimin, ndryshimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

⁴Grupi punues qeveritar udhëhiqet nga Ministri i financave dhe anëtarët tjerë në nivel të udhëheqësve janë: MD, MPB, MTI, MPMS, PK, DK, ATK, Kryeprokurori i shtetit, BQK, Gjykata supreme, Agjensia kundër korrupsion dhe NJIF-i.

3. OBJEKTIVI, METODOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET

3.1. *Objektivi*

Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e veprimit të Republikës së Kosovës 2014-2018. Qëllimi i Raportit vjetor të gjendjes 04/2015 është që t'i sigurojë Qeverisë, kontribuesve të tjerë në kuadër të regjimit të parandalimit si dhe shoqërisë si tërësi, informata në lidhje me statusin e implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Qëllimi i Raportit vjetor të gjendjes 04/2015 është gjithashtu të sigurojë një analizë të ekonomisë joformale dhe pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare brenda Kosovës. Nga ana tjetër, i njëjti përfshin informata në lidhje me rezultatet operative të organeve administrative, zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit të cilat janë përgjegjëse për masat parandaluese në luftën kundër këtyre dukurive të dëmshme.

Për më tepër, nëpërmjet këtij raporti synohet ofrimi i informatave Qeverisë dhe kontribuesve të tjerë në identifikimin e trendeve të reja të krimit dhe fenomeneve, si dhe praktikave të mira sa i përket parandalimit të ekonomisë joformale dhe krimit financiar.

3.2. *Metodologjia*

3.2.1. Kontribuesit

Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për mbështetjen e Grupit punues qeveritar në miratimin, rishikimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018. Ata ndihmohen nga Sekretariati, i themeluar nga Ministria e Financave.

Sekretariati do ta hartojë raporte të gjendjes faktike gjashtëmujor për miratim nga Grupi punues qeveritar.

Sekretariati drejtohet nga një përfaqësues i Ministrisë së Financave. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga:

- Ministria për Integritet Evropian;
- Policia e Kosovës;
- Dogana e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës;
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës;
- Koordinatori Kombëtar për krime ekonomike;
- Ministria e Drejtësisë.

3.2.2. Metodat direkte

3.2.2.1. *Takimet dhe intervistat*

Gjatë vitit 2015 janë organizuar rreth 4 takime, 3 takime te Sekretariatit dhe 1 takim pune te Grupit punes qeveritare, ku temat e këtyre takimeve kishin të bëjnë me natyrën dhe shtrirjen e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve ekonomike dhe financiare si dhe statusin e implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit.

Anëtarët e Sekretariatit kanë intervistuar edhe përfaqësues të institucioneve përkatëse. Rezultatet e këtyre takimeve janë marrë në konsideratë gjatë analizimit të situatës aktuale dhe përgatitjes së Raportit vjetorë të gjendjes 04/2015.

3.2.3. Metodat indirekte

Metodat indirekte përfshinë grumbullimin dhe analizimin e të dhënave në krahasim me raportet e mëparshme të vlerësimit të rrezikut, si dhe statistikave në lidhje me performancën strategjike dhe operative. Gjatë procesit të pranimit të statistikave është vërejtur një mangësi në cilësinë e këtyre statistikave ngase në të shumtën e rasteve nuk janë ofruar të dhënat e kërkuara, dhe apo kanë qenë me mangësi të theksuara në kompletimin e tyre.

3.3. Përkufizimet

Ekonomia joformale

Ekonomia joformale përbëhet nga ekonomia gri joformale dhe ekonomia e zezë joformale.

Ekonomia gri joformale

Ekonomia gri joformale përbëhet nga aktivitete që janë produktive dhe të ligjshme, por fshihen qëllimisht nga autoritetet publike për ta shmangur pagesën e taksave dhe/ose kontributeve të sigurimeve shoqërore ose për t'iu përmbajtur rregullave. Të ardhurat nga ekonomia gri joformale duhet të taten. Ky përkufizim është në përputhje me atë të OECD-së.⁵

Ekonomia e zezë joformale

Ekonomia e zezë përbëhet prej të ardhurave nga krimi. Ajo përfshin aktivitetet prodhuese që gjenerojnë të mira dhe shërbime të ndaluara me ligj ose që janë të paligjshme, kur kryhen nga prodhues të paautorizuar. Ky përkufizim është në përputhje me atë të OECD-së.⁶

Pastrimi i parave

⁵Matja e Ekonomisë jo të observuar- Një manual, OECD, 2015.

⁶Ibid.

Pastrimi i parave nënkupton⁷ çdo sjellje me qëllim të maskimit të origjinës së parave apo pasurisë tjetër të fituar nga një vepër dhe përfshin:

1. Konvertimin ose çdo transferim të parave apo pasurisë tjetër që buron nga veprimtaria kriminale;
2. Fshehjen ose maskimin e natyrës së vërtetë, origjinës, vendndodhjes, ofrimit, lëvizjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me para ose pasuri tjetër që rrjedh nga veprimtaria kriminale.

Financimi i terrorizmit

Financimi i terrorizmit nënkupton⁸ ofrimin ose mbledhjen e fondeve, në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim që ato të përdoren ose duke e ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht, për kryerjen e ndonjë prej veprave penale në kuptimin e nenit 138 të Kodit Penal të Kosovës dhe brenda përcaktimeve të veçanta të parapara në Rekomandimet e FATF.

Krimet financiare

Krimet financiare përfshijnë krimet ekonomike dhe financiare të përcaktuara nga Grupi Punues kombëtar për vlerësimin e rrezikut.⁹

⁷Neni 2 i Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, 2010. (aprovimi i ligjit të ri në 2010)

⁸Po aty.

⁹Lista e krimeve ekonomike dhe financiare të përcaktuara nga Grupi Punues kombëtar për vlerësimin e rrezikut, 2013.

4. ANALIZA E GJETJEVE NË PARANDALIMIN E EKONOMISË JOFORMALE, PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE DHE FINANCIARE

4.1. Zhvillimi i regjimit për luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar në Kosovë

Republika e Kosovës ka një spektër të gjerë të instrumenteve për luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimet financiare. Hartimi i kornizës ligjore, autoritete te specializuara, politika dhe strategji për luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare kanë pasur një ndikim pozitiv në shoqëri si dhe në efikasitetin e masave parandaluese.

Masat e Qeverisë për parandalimin e ekonomisë joformale kanë pasur një ndikim pozitiv dhe si rrjedhojë shuma totale e të hyrave të mbledhura është rritur në vazhdimësi. Nga ana tjetër, krimet financiare janë zbuluar dhe hetuar si dhe personat e përfshirë janë ndjekur penalisht dhe dënuar. Për më tepër, procedura penale ofron informata të cilat mund të shfrytëzohen gjatë planifikimit dhe zbatimit të masave të parandalimit dhe ndërgjegjësimit duke u përqendruar në ekonominë joformale dhe krimet financiare

Institucionet përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizmat e tyre për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Këto aktivitete përfshijnë ndërmarrjen e masave për arritjen e zhvillimeve të mëtutjeshme në fushat si në vijim:

- Është e rëndësishme të vazhdohet me zhvillimin e mëtutjeshëm të ambientit të bërit biznes në vend që do të parandalonte ekonominë joformale, dhe do të rriste konkurrueshmërinë e cila do të reflektonte pozitivisht në tërheqjen e investimeve të huaja. Në lidhje me këtë veprim, Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë për zhvillimin e sektorit privat, me saktësisht NVM-ve, 2013 - 2017 e cila ka për qëllim zhvillimin e një sektori konkurrues privat. Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e ekonomisë joformale. Të dy këto kanë rritur mbledhjen e të hyrave dhe kane vazhduar me aktivitetet e parandalimit te ekonomisë joformale duke zhvilluar mekanizmat e tyre të vlerësimit të rrezikut, aktivitetet sensibilizuese dhe strukturat organizative;
- Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kërkon që Banka Qendrore e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës të kenë procedura të brendshme efektive, bashkëpunimi dhe marrëveshje mirë-funksionale me sektorin publik, privat dhe të tretë. Dhe, të dy këto agjenci kanë të zhvilluara proceset e brendshme të punës dhe organizatat e tyre janë efektive në parandalimin e ekonomisë joformale, duke rritur vetëdijen, krijimin e udhëzimeve dhe duke krijuar legjislacionin sekondar për sektorin e trete. Gjithashtu, kanë zhvilluar funksionet e tyre mbikëqyrëse ku Banka Qendrore e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të siguruar vazhdimin e bashkëpunimit te tyre bilateral. Ky veprim ka rezultuar me kryerjen e inspektimeve të përbashkëta në sektorin financiar me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit.
- Përgjegjësia kryesore për procedurën penale për krimet financiare i mbetet Policisë së Kosovës, Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Efikasiteti i zbatimit të ligjit dhe kompetencave gjyqësore është zhvilluar duke krijuar Kodin e ri të Procedurës Penale, Kodin Penal dhe Ligjin mbi Kompetencat e zgjeruara për Konfiskim të Pasurive të Fituara nga Veprat Penale. Këto instrumente ligjore përfshijnë mjete të cilat janë të bazuara në standardet ndërkombëtare dhe të cilat ofrojnë mekanizma efikas për procedurën penale për krimet financiare. Sa i përket strukturës organizative, Policia e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës kanë zhvilluar organizatat e

tyre ne përputhje me kërkesat e krijuara operacionale. Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës kanë intensifikuar funksionet e tyre duke i bashkuar funksionet e tyre hetimore me qëllim të luftimit të ekonomisë joformale dhe krimeve ekonomike. Vlen të theksohet së gjatë vitit 2015 Doganat e Kosovës, ATK dhe policia kanë krijuar njësinë e përbashkët për gjurmimin dhe konfiskimin e asetëve të fituara nga krimi, për të ndihmuar në bashkërendimin e aktiviteteve në luftimin e krimeve ekonomike.

- Gjithashtu, gjatë vitit 2015 është nënshkruar “Marrëveshja gjithëpërfshirëse bashkëpunuese” ndërmjet institucioneve dhe agjensioneve zbatuese të ligjit me qëllim të shkëmbimit të informatave, vlerësim të riskut, dhe koordinim më efikas në luftimin e ekonomisë joformale dhe krimeve ekonomike.
- Krijimi i grupit ndër-institucional ndërmjet institucioneve dhe agjensioneve zbatuese të ligjit për shënjestrimin e top rasteve të krimeve të rënda financiare dhe të korrupsionit.

4.2. Implementimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018 nga 01.1.-31.12.2015

4.2.1. Krijimi i mekanizmave për implementim dhe mbikëqyrje

Strategjia Kombëtare 2014-2018 identifikon institucionet e obliguara dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë dhe Planit të veprimit. Në të gjithashtu përshkruhen proceset të cilat duhet të aplikohen gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve.


Kontribuesit e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare 2014-2018 janë Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, Grupi punues qeveritar, Sekretariati, Grupi punues teknik, dhe institucionet e sektorit publik, privat dhe të tretë përgjegjëse për implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Të gjithë këta janë aktivizuar përmes këtyre masave:

- Ministri i Financave, si përfaqësues i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka ftuar Grupin punues qeveritar të përbërë nga përfaqësues të ministrive dhe agjencive të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare 2014-2018 në mbledhjen e tij të tretë më 26.06.2015, me qëllim të aprovimit të raportit vjetor 2014
- Sekretariati ka vazhduar me organizimin e takimeve dhe punëtorisë për monitorimin e implementimit të PV të Strategjisë, dhe ka analizuar të dhënat me qëllim të hartimit të raportit vjetor,
- Raportimi i rezultateve të procesit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 ka vazhduar duke shfrytëzuar Instrumentin e monitorimit dhe rishikimit për Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018 e cila është një aneks i Strategjisë Kombëtare 2014-2018
- Gjatë vitit 2015, Institucionet përgjegjëse kanë përfunduar tashmë (4) aktivitete, dhe kanë iniciuar rreth (5) aktivitete të përcaktuara në Planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018,
- Sekretariati ka hartuar Raportin vjetorë për gjendjen me të cilin Grupi punues qeveritar do t'i raportojë Qeverisë së Republikës së Kosovës për implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018 duke shfrytëzuar Instrumentin e lartpërmendur të monitorimit dhe rishikimit dhe për të ofruar informata në lidhje me rezultatet e aktiviteteve operative përkitazi me parandalimin dhe procedurën penale kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar;

- Sekretariati ka marrë pjesë aktive në implementimin e projektit të PECK-ut për identifikimin e mangësive dhe rekomandimet kryesore të raporteve përfundimtare të vlerësimit në lidhje me pajtueshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushat e luftës kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e mbajtur me 28 Prill 2015 në Prishtinë.
- Ministria e financave dhe NJIF-K kanë iniciuar ndryshimin e ligjit për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit, ku si rezultat është krijuar grupi punues për hartimin e koncept dokumentit për rishikimin dhe amendamentimin e ligjit për Pastrimin e parave konform standardeve të TFVF.

Mekanizmi për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018 është paraqitur në grafikun e mëposhtëm të procesit.

Grafiku 1: Grafiku i procesit të implementimit dhe mbikëqyrjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018



Burimi: Sekretariati dhe Ekipi i projektit të BE-së, 2014

4.2.2. Strategjia Kombëtare dhe Planit i veprimit 2014-2018 dhe statusi i implementimit të tyre

4.2.2.1. *Të përgjithshme*

Strategjia Kombëtare 2014-2018 përbëhet nga gjithsej gjashtë (6) objektiva strategjike të cilat konsiderohen thelbësore për menaxhimin e rreziqeve që ndërlidhen me ekonominë joformale dhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare. Planit i veprimit i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përfshinë 51 aktivitete implementimi i të cilave siguron arritjen e objektivave dhe rrjedhimisht edhe menaxhimin e rreziqeve.

Statusi i implementimit të Planit kombëtar dhe Planit të veprimit 2014-2018 është përshkruar më poshtë. Më shumë informacione specifike në lidhje me përmbajtjen e veprimeve të veçanta të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 dhe statusin e implementimit të tyre mund të gjenden nga Shtojcën 1. Shtojca 1 përbëhet nga instrumenti i Monitorimit dhe Shqyrtues cila kërkohet të shfrytëzohet në Strategjinë Kombëtare 2014-2018.

4.2.2.2. *Ngritja e vetëdijes mbi ndikimet dhe për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimin financiar*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Ngritja e vetëdijes mbi ndikimet dhe për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimin financiar" do të bëhet duke zbatuar që të gjitha katër (4) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.1.1 - 2.1.4 të cilat janë të përfshira në Planin e veprimit. Institucionet përgjegjëse kanë implementuar që të gjitha (4) aktivitetet.

.

4.2.2.3. *Forcimi i parandalimit dhe lufta kundër ekonomisë joformale dhe krimin financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqëror.*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Forcimi i parandalimit dhe lufta kundër ekonomisë joformale dhe krimin financiar duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqëror" do të bëhet duke zbatuar që të gjitha trembëdhjetë (13) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.2.1 - 2.2.13 të cilat janë të përfshira në Planin e veprimit. Gjatë vitit 2015, institucionet kanë përfunduar (1) aktivitet (2.2.10), ndërsa në proces është aktiviteti (2.2.5 dhe 2.2.11).

Rreziqet e identifikuara

Institucionet përgjegjëse nuk i kanë raportuar Sekretariatit për ndonjë rrezik në lidhje me procesin e implementimit.

4.2.2.4. *Promovimi i zbulimit, hetimit, prokurorisë, gjykatave dhe procedurave të zbatimit për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Promovimi i zbulimit, hetimit, prokurorisë, gjykatave dhe procedurave të zbatimit për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare" do të bëhet duke zbatuar që të gjitha tetë (8) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.3.1 - 2.3.8 të cilat janë të përfshira në Planin e veprimit. Institucionet përgjegjëse gjatë vitit 2015 kanë përfunduar (1) aktivitet (2.3.8), dhe kështu është konkluduar implementimi i këtij objektivit në tërësi.

4.2.2.5. *Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse" do të bëhet duke zbatuar që të gjitha shtatë (7) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.4.1 - 2.4.7 të cilat janë të përfshira në Planin e veprimit. Gjatë vitit 2014, institucionet përgjegjëse kanë zbatuar tre (3) aktivitete (2.4.1, 2.4.4 dhe 2.4.5), ndërsa aktivitetet tjera nuk kane filluar se implementuari as në vitin 2015.

Rreziqet e identifikuara

Sekretariati është duke mbledhur informata në baza mujore për rezultatet operative të organeve përgjegjëse administrative, zbatimit të ligjit dhe gjyqësore për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Kjo bazohet në aktivitetin 2.4.1 i cili ka për synim përmirësimin e menaxhimit të performancës së institucioneve përkatëse. Sekretariati kanë vënë re se informatat për rezultatet operative nuk janë të plota dhe konsistente. Kjo sidomos ka të bëjë me fazën e prokurorisë dhe përdorimin e aktgjykimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim. Një gjë e tillë përbën rrezik për implementimin e veprimit 2.4.1.

Instituti për Krime Ekonomike i cili është përgjegjës për aktivitetin 2.4.3 ka raportuar tek Sekretariati që statusi i institutit ende nuk është përcaktuar. Kjo përbën një rrezik për implementimin e veprimit 2.4.2. Nga ana tjetër, Instituti për Krime Ekonomike i ka raportuar Sekretariatit se Qeveria nuk i ka alokuar 30 000 Euro të kërkuara për zbatimin e Programit të trajnimeve për Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës dhe të institucioneve të tjera të angazhuara në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Këto dy çështje përbëjnë rreziqe për zbatimin e veprimeve 2.4.2 dhe 2.4.3. Megjithatë, pas diskutimeve të shumta me krerët e policisë së Kosovës është vendosur që aktivitetin 2.4.2 ta ndërmerret policia e Kosovës që gjithashtu do të ofrojë mbështetjen infrastrukurore, dhe me këtë dakordim shuhet edhe roli i Institutit për krime ekonomike. Megjithatë, kushti i policisë është se duhen fonde prej 30,000 euro vjetore, fonde këto që ende nuk janë alokuar, për realizimin e këtij aktiviteti i cili ndërlidhet me kompensimin e trajnerëve për orët e ligjëratave. Ky veprim është riformuluar dhe reflektuar me rishikimin e planit të veprimit 2015-2018.

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet 2.4.1 dhe 2.4.4 - 2.4.7 të Planit të veprimit nuk i kanë raportuar Sekretariatit ndonjë rrezik shtesë në lidhje me procesin e implementimit.

4.2.2.6. *Zhvillimi dhe aplikimi i një qasje proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Zhvillimi dhe aplikimi i një qasje pro aktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare" do të bëhet duke zbatuar që të katër (4) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.5.1 - 2.5.4 të cilat janë të përfshira në Planin e veprimit. Institucionet përgjegjëse tashmë kanë implementuar aktivitetet (2.5.3, 2.5.4), ndërsa aktivitetet (2.5.1, dhe 2.5.2) janë në proces të implementimit.

Rreziqet e identifikuara

NjIFK-ja e cila është përgjegjëse për aktivitetin 2.5.2 i ka raportuar Sekretariatit që inicimi i procesit për anëtarësimin e NJIF-K në Egmont Group ka filluar në vitin 2013. Procedura për anëtarësimin e NJIF-k ishte përfshirë në agjendën e mbledhjes së grupeve punuese të Egmontit fillimisht në grupin e arritshmërisë e pastaj edhe në grupin ligjor të punës.

Në fund të muajit Janar 2015 është mbajtur takimi i Grupit Egmont në Berlin, Gjermani. Njëra nga pikat e diskutimit në takimin e grupit ligjor ka qenë edhe plotësimi i kushteve për anëtarësim nga ana e NJIF-k. Njëri nga rekomandimet ka qenë që Kosova duhet ti bëjë ndryshimet ligjore sa i përket financimit të terrorizmit, me qëllim që pjesa ligjore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Kosova të vazhdoj rruën e anëtarësimit në Egmont group.

Qeveria duhet të sigurojë që ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit është në përputhje me standardet ndërkombëtare gjë që nuk do të paraqiste pengesë për anëtarësimin e NJIF-it në Egmont group and ky veprim (aprovimi i ligjit) duhet të bëhet jo më larg se muaji qershor 2016.

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet 2.5.1, 2.5.3 dhe 2.5.4 të Planit të veprimit nuk i kanë raportuar Sekretariatit për ndonjë rrezik shtesë në lidhje me procesin e implementimit.

4.2.2.7. *Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare duke siguruar zbatimin e tij efikas*

Statusi i implementimit

Implementimi i objektivit të Strategjisë Kombëtare "Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare duke siguruar zbatimin e tij efikas" do të bëhet duke zbatuar që të gjitha pesëmbëdhjetë (15) aktivitetet. Bëhet fjalë për veprimet 2.6.1 - 2.6.15 të cilat janë të përfshira në Planin e

veprimit. Institucionet përgjegjëse kanë nisur zbatimin e një (1) veprimi (2.6.1). Procesi i zbatimit i të gjitha katërmbëdhjetë (14) aktiviteteve (2.6.2 - 2.6.15) akoma nuk ka filluar.

Rreziqet e identifikuara

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet 2.6.1 – 2.6.15 të Planit të veprimit nuk i kanë raportuar Sekretariatit për ndonjë rrezik në lidhje me procesin e implementimit.

4.2.3. Gjetjet

Sekretariati ka analizuar statusin e implementimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018. Gjetjet që janë bërë në bazë të informatave të mbledhura nga institucionet përkatëse pasqyrojnë të arriturat gjatë periudhës 01.01-31.12.2015, dhe janë si vijon:

- Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 gjatë 2015 kanë përfunduar katër (4) aktivitete dhe iniciuar (5) aktivitete.
- Vlen të theksohet se deri në fund të vitit 2015 numri i aktiviteteve të implementuara është në total 39 aktivitetet nga 51 aktivitete në total, që njëherit paraqet rreth 76% të implementimit të planit të veprimit.
- Informatat e kërkuara, të mbledhura në baza mujore, për rezultatet operative dhe punën e institucioneve përgjegjëse administrative, zbatimit të ligjit dhe të gjyqësorit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare nuk janë të plota dhe konsistente. Kjo ka të bëjë sidomos me fazën e prokurorisë dhe përdorimin e aktgjykimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim. Kjo përbën një rrezik për realizimin e objektivit strategjik "Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse" dhe aktivitetin 2.4.1 të Planit të veprimit;
- Mos-anëtarësimi i NJIF-K në Egmont grup ka ndodhur si rezultat i ekzistimit të zbrazëtirave ligjore në ligjin PPP/PFT është konsideruar të përbëjë një rrezik për realizimin e objektivit strategjik "Aplikimi i një qasje pro-aktive për bashkëpunim ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare" dhe aktivitetin 2.5.2 të Planit të veprimit.
- Mungesa e dispozitave ligjore të qarta në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sa i përket raportimit të financimit të dyshuar të terrorizmit përbën një rrezik për zbatimin e objektivit strategjik "Zhvillimi dhe aplikimi i një qasje pro-aktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare" dhe aktivitetit 2.5.2 të Planit të Veprimit i cili ka të bëjë me anëtarësimin e NJIF-K-së Egmont Group.
- Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal të e Kosovës për të përfshirë edhe penalizimin e një kundërvajtje të kontabilitetit, sepse përcaktimet në lidhje me veprat penale të kontabilitetit janë shumë të përgjithshme. Në Kodin Penal duhet të jetë një nen specifik në bazë të cilit një person me një detyrim ligjor për të mbajtur llogaritë, përfaqësuesi i tij ose të saj, personi i cili ushtron autoritet aktual vendimmarrës në një shoqëri me një detyrim ligjor për të mbajtur libra, ose personi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit/llogarive, përbën rrezik në implementimin e aktivitetit 2.6.2.
- Sigurimi i zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare që në shënjestër kanë terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, si dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë përmes rishikimit të Ligjit për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, duke siguruar ngrirjen e fondeve dhe të pasurive siç kërkohet me sanksione ndërkombëtare. Ligji për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare nuk

përshkruan në detaje të mjaftueshme masat praktike të zbatimit në lidhje me ngrirjen e fondeve dhe aseteve, gjë që përbën rrezik në implementimin e aktivitetit 2.6.4.

- Mangësitë e identifikuara në Kodin e procedurës penale (Neni 90) në lidhje me ndërmarrjen e masave të fshehta dhe teknike me veprat e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave, si dhe sigurimi i pajtueshmërisë së Kodit Penal me Rekomandimet e TFAF duke ndryshuar sanksionimin e financimit të terrorizmit dhe duke ndryshuar nenin 97 të Kodit Penal në mënyrë që të përshkruhet në mënyrë të qartë përdorimi i plotë i konfiskimit të bazuar në vlerë, përbën rrezik në implementimin e aktivitetit 2.6.5. dhe 2.6.6.

4.3. Rezultatet Operative mbi Parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe financiare 2008-2014

4.3.1. Objektivat operative të përcaktuara në Planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018

Shtojca 1 e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përbëhet prej treguesve kyç të performancës për fazat e ndryshme të procesit operativ të parandalimit të ekonomisë joformale dhe kimit financiar. Treguesit specifikë janë të përcaktuara për proceset e mëposhtme:

- Mbledhja e detyrueshme e detyrimit tatimor të pagueshëm dhe tarifave doganore;
- Procesi i Inteligjencës/zbulimit në lidhje me pastrimin e parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
- Hetimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
- Ndjekja penale sa i përket pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;

4.3.2. Parandalimi i ekonomisë joformale

Kalkulimet e fundit makroekonomike të kryera në vitin 2014, vlerësim i kryer nga Projekti i BE¹⁰, tregojnë se niveli i ekonomisë joformale në Kosovë me përfshirjen e remitancave të pranuar nëpërmjet institucioneve financiare ishte 38.21% e BPV-së në vitin 2013. Si vlerë totale kjo është e barabartë me 2.035.000.000 €, ku në përgjithësi 30% e kësaj vlere është rezultat i evazionit tatimor. Humbja e të hyrave vetëm prej tatimit në të ardhura është rreth 63.720.000 € ndërsa pjesa e mbetur prej 8% është prej burimeve të paspecifikuara dhe përfaqëson 441.950.000 € të vlerës totale.

Vlerësimi i pjesëmarrjes së ekonomisë së zezë në totalin e ekonomisë joformale është bërë me metodën direkte, dhe kjo analizë ka treguar se minimumi i 172.000.000€ nga 441.950.000€¹¹ ka rezultuar prej aktiviteteve të ekonomisë së zezë. Kjo është vlerë e ulët duke i marrë për bazë karakteristikat e mjedisit operues në Kosovë, dhe për këtë shkak është konstatuar se potencialisht e tërë vlera e 441.950.000€ apo një pjesë e madhe e saj bazohet në të ardhurat nga krimi.

¹⁰Mbështetje për institucionet e Kosovës në luftimin e krimit ekonomik dhe financiarë-‘Vlerësimi mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë. Projekt i BE-së 132399/C/SER/XK 04/12/2014

¹¹Mbështetje për institucionet e Kosovës në luftimin e krimit ekonomik dhe financiarë-‘Vlerësimi mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë. Projekt I BE-së 132399/C/SER/XK 04/12/2014

Shuma totale e të hyrave buxhetore bruto të Qeverisë së Republikës së Kosovës është rritur gjatë viteve 2011-2015 nga 1,309.9 në 1,492.5 miliardë euro. Të hyrat doganore kanë përfaqësuar 63% të shumës totale dhe të hyrat nga tatimet 22.4%. Ekonomia joformale ndikon në të hyrat. Kjo kryesisht ka të bëjë me mjetet e mbledhura nga Administrata Tatimore, gjë që vërehet një trend rritës në inkasimin e të hyrave.

Shkalla e ekonomisë joformale në Kosovë vlerësohet të jetë në të njëjtin nivel si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimet e fundit në rajon mbulojnë periudhën kohore 2008-2013. Shkalla e ekonomisë joformale në vendet fqinje të Kosovës ndryshon mes 23-38.8% të BPV-së. Llojet e të ardhurave dhe pesha e tyre në buxhet janë të përcaktuara në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Të hyrat buxhetore bruto të buxhetit të Qeverisë së Kosovës 2011-2015 (EUR, miliona)

Lloji i të hyrave buxhetore	2011	2012	2013	2014	2015
Dogana	948,380	974,124	983,263	1,005,180	1,104,942
ATK	140,458	154,652	159,454	169,492	179,650
Te tjera	221,059	190,427	207,726	191,663	207,881
Totali	1,309,898	1,319,203	1,350,444	1,366,335	1,492,474

Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Kosovës

Shuma e përgjithshme e të ardhurave nga tatimet është rritur sistematikisht që nga viti 2011. Ky është një trend inkurajues. Megjithatë, baza tatimore duhet në vazhdimësi të zgjerohet, kjo do të ndikoj direkt në ngushtimin e ‘hendekut tatimore’ dhe zvogëlimit të ekonomisë joformale. Tabela e ilustruar më lartë paraqet trendin e të hyrave nga doganat e Kosovës dhe Administrata tatimore e Kosovës. Shihet se trendi i të hyrave ka vazhduar të rritet ndër vite dhe kjo pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve në rritjen e bazës tatimore.

Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se stoku i borxhit të përgjithshëm tatimor të papaguar në fillim të vitit 2015 ishte në vlerë prej 463,795,298.85 Euro, dhe stoku i borxhit i Doganave të Kosovës përfshirë akcizën në vlerë prej 2,742,266.51 Euro. Përpjekjet e vazhdueshme në intensifikimin e aktiviteteve për grumbullimin e tatimeve të pa-paguara do të ketë efekt pozitiv edhe në uljen e nivelit të ekonomisë joformale. Të dhënat tregojnë se vlera e stokut të borxhit në vitin 2015 ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2014, si rezultat i procesit të faljes së borxheve e cila ka bërë që ATK të kalojë një pjesë të borxhit në aktive me qëllim të inkasimit të tij. Vlenë të theksohet se rreth 50% e stokut të borxhit është i përbërë nga Ndërmarrjet shoqërore nën administrimin e AKP-së, ndërmarrjet publike dhe organizatat buxhetore. Poashtu, rreth 1/3 e borxhit është e përbërë nga kryegjëja ndërsa rreth 2/3 e pjesës së mbetur është e krijuar nga ndëshkimet dhe interesi, si rezultat i legjislacionit paraprakë ku aplikimi i normave të larta të interesit ka bërë që stoku i borxhit të shënoj rritje të përshpejtuar ndër vite. Të dhënat për stokun e borxhit për periudhën 2013-2015 janë të ilustruara në tabelën në vijim.

Tabela 2: Vlera e stokut të borxhit të tatimeve, taksave doganore dhe akcizës, (2013-2015)

Lloji i borxhit të akumuluar	Shuma e përgjithshme e borxhit të detyrueshëm		
	2013	2014	2015
Tatime	245,000,000 €	275,591,500 €	463,795,298.85 €
Taksa doganore dhe akcizë	9,134,000.77	9,500,000.00 €	2,742,266.51 €

Burimi: Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2015

4.3.3. Procedura penale për pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe financiare

4.3.3.1. *Procesi i mbledhjes së informatave (inteligjencës)*

Një nga funksionet kryesore të NJIF-it janë pranimi, kërkimi, grumbullimi, dhe analizimi i informatave financiare. Njësia e inteligjencës financiare ka vazhduar të krijojë raporte të inteligjencës dhe të bëjë shpërndarjen e tyre tek autoritetet kompetente me synimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Numri i përgjithshëm i raporteve të Aktiviteteve të Dyshimta (RAD) dhe numri i transaksioneve në të Gatshme të pranuar dhe numri i raporteve të inteligjencës të shpërndara nga NJIF-K ndër vite janë të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Tabela 3: Rezultatet Operative të NJIF-K 2015

Rezultatet e NjIF-K	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
RTD e pranuar	38	133	135	202	174	294	398
RTG e pranuar	284,592	419,615	423,443	480,479	606,778	553,651	617,430
Raportet e shpërndara	47	82	53	49	74	59	94
Inspektimet e pajtueshmërisë	n/a	n/a	n/a	-	-	35	26

Burimi: NJIF-K, 2015

Numri i raporteve të pranuar dhe të shpërndara të inteligjencës është rritur 2009-2015, megjithatë në vitin 2015 NjIF-K ka pranuar 617,430 RTG në vitin 2015 ose një mesatare prej rreth 51,452 RTG për muaj. Kjo tregon një ngritje prej rreth 12% më tepër se sa në vitin paraprak (2014: 553,651). Duke krahasuar raportimet e RTG-ve me vitet e kaluara, viti 2015 ka shënuar numrin më të madh të raportimeve, si në numrin e transaksioneve ashtu edhe në numrin e raporteve të dërguara, por shprehur në vlera monetare, raportimi i transaksioneve në para të gatshme ka mbetur i përafërt me vitin e kaluar, duke pësuar një rënie të vogël prej rreth 3%.

Një zhvillim të rëndësishëm për vitin 2015 përbën rritja e numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara (94) për tek institucionet tjera, duke shënuar progresin më të lartë të raporteve të shpërndara në pesë vitet e fundit. Duke krahasuar me vitin paraprak në të cilin janë shpërndarë gjithsej 59 raporte, viti 2015 ka rezultuar me një ngritje prej rreth 59% duke tejkaluar njëherit edhe objektivat e përcaktuara në planin e performances së NjIF-K dhe treguesit kyç të performances së Strategjisë Kombëtare 2014-2018, të cilat kanë paracaktuar 80 numrin minimal të raporteve të inteligjencës të shpërndara në autoritetet e mandatuara për vit kalendarik 2015.

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me obligimet ligjore për parandalimin e pastrimi të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit mbetet një ndër funksionet kryesore të Njesisë për Inteligjencë Financiare. Bazuar në analizën e rrezikut të pajtueshmërisë, inspektimet janë orientuar ndaj atyre sektorëve të cilët më së paku kanë raportuar në NjIF-K si këmbimore, kompani të sigurimeve dhe OJQ

4.3.3.2. *Hetimet paraprake dhe procedurat gjyqësore për krimet financiare*

Gjatë periudhës kohore 2008-2014, numri i përgjithshëm i hetimeve të filluara në lidhje me krimet financiare ishte më i lartë në vitin 2013. Nga ana tjetër, numri i dënimeve për krime financiare ishte më i ulët në vitin 2013. Rezultatet ishin si më poshtë:

Rezultatet në lidhje me numrin e hetimeve të filluara në krimet financiare kanë qenë si në vijim:

Tabela 4: Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2008-2014

Hetimet e filluara për krime financiare	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Policia	3 043	2 123	2 774	2 914	2 135	3372	2784	2,019
Dogana	90	57	64	69	49	165	104	95
Administrata Tatimore	-	-	-	-	-	-	25	56
Gjithsej	3 133	2 180	2 838	2 983	2 184	3 537	2 913	2,170
<hr/>								
Dënimet për krime financiare	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Gjykatat Themelore ¹²	1 391	1 541	1 298	1 318	1 339	1 296	1 756	3,489

Burimi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2015

¹²Gjykatat Themelore nga 2013 e më tutje.

Analiza statistikore tregon se në vitin 2015 krimet më të zakonshme financiare të pranuar gjatë hetimeve të procedurës paraprake¹³ ishin:

- Mashtrimet;
- Falsifikimi i valutave;
- Blerja, marrja apo fshehja e mallrave të përfituara përmes kryerjes së një vepre penale; dhe
- Zaptimi joligjor i pasurisë së patundshme.

Sa i përket procedurave gjyqësore, krimet financiare më të zakonshme për të cilat Gjykatat Themelore kanë dhënë dënime¹⁴ në vitin 2014 ishin:

- Falsifikimi i valutave;
- Mashtrimet;
- Zaptimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme; dhe
- Kontrabandimi i mallrave.

4.3.3.3. Pasuria e sekuestruar dhe konfiskuar

Një parandalim efektiv i krimeve financiare kërkon sekuestrim dhe konfiskim të të ardhurave nga krimi. Agjencia për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar mban statistika në baza vjetore lidhur me numrin e përgjithshëm dhe vlerën e vendimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe aktgjyqimeve për konfiskim. Agjencia nuk ka informata specifike në lidhje me përdorimin e këtyre masave gjatë procedurave penale për krimet financiare. Megjithatë, vlera e përgjithshme e aseteve, objekt i sekuestrimit të përkohshëm dhe konfiskimit, janë si më poshtë.

Tabela 5: Vlera e fondeve të sekuestruara dhe konfiskuara nën menaxhimin e Asgjësisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruara dhe konfiskuar, 2010-2015

Masat ligjore në lidhje me të ardhurat nga krimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Sekuestrimi i përkohshëm	0 €	41 852,31 €	2 482 903,54 €	1 555 258,43 €	21,256,142.7 €	813,309.40 €
Konfiskimi	1 720,00 €	26 765,35 €	103 647,57 €	6 700,00 €	26 350.90 €	169,312.70 €

Burimi: Agjencia për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, 2015

Informatat në dispozicion dëshmojnë se vlera e përgjithshme e të ardhurave të sekuestruara është rritur në krahasim me periudhën e vitit 2010 dhe 2011. Megjithatë, në vitin 2015 shihet se vlera e pasurive të sekuestruara është relativisht e ulët në krahasim me vitin 2014, por që është më e lartë në krahasim me vitin 2013. Në anën tjetër, shihet se vlera e aseteve të konfiskuara në vitin 2015 ka shënuar rritje në krahasim me vitet paraprake, ku vlera arriti në 169,312.71 mijë EUR. Pavarësisht, rritjes së shënuar, potencilet e rritjes

¹³Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2008-2014; Sekretariati

¹⁴Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2010-2015; dhe Sekretariati.

së vlerës së asetëve të konfiskuara duhet të jenë më të larta duke pasur parasyshë që niveli i ekonomisë joformale është relativisht i lartë.¹⁵

4.3.4. Gjetjet

Sekretariati ka analizuar rezultatet operative të parandalimit të ekonomisë joformale dhe procedurave penale për krimet financiare gjatë vitit 2014. Gjetjet që janë bërë në bazë të informatave të mbledhura nga institucioni përkatës janë si në vijim:

- Gjatë vitit 2011-2015, tarifatat doganore kanë përfaqësuar 63% të shumës totale të ardhurave dhe kanë shënuar rritje mesatare vjetore prej rreth 3%;
- Shuma e përgjithshme e të ardhurave tatimore është rritur sistematikisht gjatë 2011-2015 dhe kanë përfaqësuar 22.4% të shumës totale të ardhurave, duke shënuar rritje mesatare prej rreth 6%;
- Vlera e përgjithshme e borxhit tatimor të vonuar me 01.01.2015 ishte 463,795,298.85EUR dhe borxhi për taksat doganore dhe akcizë ishte 2,742,266.51 EUR. Ndërsa vlera e përgjithshme e borxhit të mbledhur gjatë vitit 2015 nga ATK ishte 19,598,237.00 EUR dhe Doganat e Kosovës 2,240,321.73 EUR.
- Numri i përgjithshëm i raporteve për transaksione të dyshimta të pranuar dhe raporteve të shpërndara të inteligjencës nga NJIF-K janë rritur në mënyrë të konsiderueshme duke arritur në 398 RTD respektivisht 94 raporte të shpërndara në vitin 2015,
- Numri vjetor i krimeve financiare të regjistruara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe ATK gjatë vitit 2015 janë regjistruar të jenë 2,170 duke shënuar një rënie prej 743 në krahasim me vitin 2014;
- Numri vjetor i dënimeve të Gjykatës Themelore në lidhje me krimet financiare ka mbetur i qëndrueshëm, dhe shënuar rritje nga 1756 (2014) në 3489 (2015);
- Vlera e përgjithshme e pasurisë së sekuestruar në vitin 2014 është rritur ndjeshëm duke arritur vlerën prej 21 256 142,70 EUR, përderisa në vitin 2015 vlera e pasurisë së sekuestruar arriti në 813,309.4 EUR;
- Vlera e përgjithshme e pasurisë së konfiskuar në vitin 2015 ishte 169,312.71 EUR;

4.4. Rezultatet operative të parandalimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare dhe ekonomike në periudhën ndërmjet janarit dhe marsit 2014.

4.4.1. Objektivat operative të përcaktuara në Plan Veprimin e Strategjisë Kombëtare 2014 - 2018

Një menaxhim i duhur i performancës në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare kërkon indikatorë konkret kyç të performancës. Rrjedhimisht, procesi duhet të ndahet në faza të ndryshme për të siguruar identifikimin e duhur të indikatorëve dhe matje të rezultateve.

Plani i veprimit i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përbëhet nga indikatorë kyç të performancës për faza të ndryshme të procesit operativ lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet financiar. Indikatorët specifik përcaktohen për proceset në vijim:

- Mbledhja e detyrueshme e tatimeve dhe taksave doganore të prapambetura;

¹⁵Statistikat 2010-2014, Agjencia për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, 2015

- Procesi i mbledhjes së informatave për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare;
- Hetimi i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
- Ndjekja në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet e tjera financiare;
- Procedurat gjyqësore në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet e tjera financiare.

4.4.2. Parandalimi i ekonomisë joformale

Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017 parasheh dy supozime kryesore që pritet të ndikojnë në arkëtimin e të hyrave: të hyrat shtesë si rrjedhojë e rritjes së vëllimit të aktivitetet real ekonomik si rezultat i parashikimit të nivelit të ulët të çmimeve në periudhë afat-mesme, nga implementimi i suksesshëm i strategjisë dhe planit të veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale dhe nga përmirësimi i vazhdueshëm i ambientit të bërit biznes si rezultat i aplikimit të pakove fiskale. Pritet që zbatimi i suksesshëm i këtyre politikave, do të bëjë të mundur uljen e hendekut tatimor nëpërmjet formalizimit të vazhdueshëm të aktiviteteve ekonomike, e cila do të sigurojë një buxhet të qëndrueshëm të ardhurave për vitet e ardhshme.

Aneksi I i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 nuk përbëhet nga objektivat specifike për mbledhjen e të hyrave. Megjithatë, rezultatet e arritura në këtë drejtim janë një tregues i rëndësishëm kur bëhet matja e efikasitetit të luftës kundër ekonomisë joformale. Poashtu, me vlerësimin e nivelit të ekonomisë joformale janë identifikuar masa shtesë që do të ndikojnë në uljen e hendekut tatimore. Shuma totale e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2014 dhe 2013 në frekuenca mujore është si vijon:

Tabela 6: Vlera e mbledhur e të hyrave nga tatimet, doganat dhe të hyrave tjera neto Janar-Dhjetor 2015 dhe 2014, në miliona euro

Të hyrat buxhetore	Jan-15	Shkurt 2015	Mars 2015	Prill 2015	Maj 2015	Qersh 2015	Korrik 2015	Gusht 2015	Shtator 2015	Tetor 2015	Nentor 2015	Dhjetor 2015	Totali
Të hyrat nga dogana	47.2	52.1	67.5	74.9	76.1	84.0	95.5	95.5	86.4	90.3	81.0	99.7	950.1
Të hyrat nga ATK	41.1	21.3	22.0	39.7	18.3	20.8	36.5	20.5	27.0	42.4	20.5	24.2	334.5
Të hyrat tjera	12.3	11.2	18.3	29.6	11.9	12.6	20.4	11.6	11.8	25.6	10.4	32.1	207.9
Totali	100.6	84.6	107.8	144.2	106.3	117.5	152.3	127.6	125.2	158.4	111.9	156.0	1,492.5
Të hyrat buxhetore	Jan-14	Shkurt 2014	Mars 2014	Prill 2014	Maj 2014	Qersh 2014	Korrik 2014	Gusht 2014	Shtator 2014	Tetor 2014	Nentor 2014	Dhjetor 2014	Totali
Të hyrat nga tatimet	36.7	18.1	20.6	37.4	18.5	17.7	33.9	19.4	20.7	34.6	19.1	28.9	305.5
Të hyrat nga doganat	45.6	52.5	66.9	68.7	70.9	77.2	81.1	85.9	83.7	80.6	67.0	89.1	869.1
Të hyrat tjera	17.8	10.8	13.0	21.5	13.6	12.0	15.8	14.4	13.3	24.9	15.4	19.1	191.7
Totali	100.2	81.3	100.5	127.7	103.0	106.8	130.8	119.7	117.6	140.1	101.5	137.1	1,366.3

Burimi: Ministra e Financave, 2015

Shuma totale e të hyrave të mbledhura neto gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015 ishte 1,492.5 euro, që njëherit është një ngritje prej rreth 9.2% apo rreth 126.14 milion euro me shumë në krahasim me vitin 2014. Të hyrat nga ATK kanë shënuar rritje prej rreth 9.5% dhe të hyrat nga Doganat shënuan rritje rreth 9.3%

në krahasim me vitin 2014. Masat e ndërmarra nga autoritetet përgjegjëse tatimore kanë dhënë rezultate pozitive dhe kjo ka reflektuar në rritjen e trendit në mbledhjen e të hyrave nga agjensionet përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave.

Shtojca 1 e Planit të veprimit 2014-2018, kërkon që rezultatet minimale vjetore të mbledhjes së detyrueshme të tatimit të prapambetur duhet të jenë 90,000,000 Euro dhe 4,500,000 Euro për taksat e vonuara doganore dhe të akcizës. Rezultatet gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2015 kanë qenë si në vijim:

Tabela 7: Vlera e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve dhe taksave doganore dhe të akcizës së prapambetur, Janar- Dhjetor 2015 dhe Janar-Dhjetor 2014

Lloji i borxhit të grumbulluar	2015												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Tatimet	841	754	1,096	799	1,068	1,719	1,336	1,189	1,411	1,108	1,069	7,208	19,598
Taksta doganore	157.4	149.7	108.9	59.3	187.8	164.8	131.3	89.8	297.8	419.3	276.0	198.2	2,240
	2014												
Lloji i borxhit të grumbulluar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Tatimet	4,222	3,417	4,394	3,176	3,732	4,970	3,868	3,616	4,090	4,337	3,875	4,042	47,739
Taksta doganore	68	155.1	204.2	126.6	78.3	193.7	0	110.6	152.9	49.8	47.8	331.65	1,518.7

Burimi: Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2015

Rezultatet e Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës janë inkurajuese por që përpjekjet për grumbullimin e borxheve të vonuara duhet të intensifikohen. Masat e ndërmarra gjatë vitit 2015 nga të dy institucionet nuk kanë prodhuar rezultate të pritshme në bazë të indikatorëve kyç të performancës.

4.4.3. Procedura penale për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe financiare

4.4.3.1. *Procesi i mbledhjes së informatave (inteligjencës)*

NjIF-K është duke mbledhur, analizuar dhe shpërndarë informata financiare. Shtojca 1 e Planit të veprimit 2014-2018 kërkon nga agjencia të marrë dhe shpërndaj një numër të caktuar të raporteve. Ajo është gjithashtu e përbërë nga objektivat në lidhje me numrin dhe vlerën e transaksioneve të pezulluara nga NjIF-K. Rezultatet e njësisë kanë qenë:

Tabela 8: Rezultatet operative të NjIFK, Janar-Dhjetor 2015

Rezultatet e NjIF-K	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtat	Tet	Nen	Dhje	Total
RTD e pranuar	30	22	27	22	64	24	28	24	43	35	21	32	372
RTG e pranuar	43,974	40,478	37,002	51,641	42,557	48,778	50,682	58,117	59,738	55,560	59,997	68,906	617,430
Raportet e pranuar për financim të terrorizmit	3	2	5	1	2	3	-	1	0	5	2	2	26
Raportet e shpërndara të inteligjencës tek autoritetet e mandatuara	6	6	4	5	11	8	8	5	10	4	6	21	94
Transaksionet e pezulluara	-	-	-	-	-	5	-	-	-	-	-	-	5
Vlera e transaksioneve të pezulluara	-	-	-	-	-	29,740	-	-	-	-	-	-	29,740

Burimi: NjIFK, 2015

Rezultatet për vitin 2015 tregojnë se NjIF-K-ja ka përmbushur dhe tejkaluar indikatorët kyç të performancës të përcaktuara në Aneksin 1 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Numri i raportimeve për transaksione të dyshimta krahasuar me vitin e kaluar është rritur për 34.92%. Gjithashtu viti 2015 ka rezultuar me një ngritje prej rreth 59 % të numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara tek autoritetet tjera, kështu duke tejkaluar edhe objektivat e përcaktuara në planin e performancës së NjIF-K.

Duhet theksuar që pavarësisht vështirësive në aspektin e numrit të stafit dhe mbështetjeve logjistike (hapësirat e punës), dhe poashtu mos pranimit i saj në Egmont group, NjIF-K ka arritur që të tregojë një performancë jashtëzakonisht të mire përgjatë vitit 2015 e cila është reflektuar edhe në të arriturat e ilustruara në tabelën më lartë.

4.4.3.2. *Hetimet paraprake për krimet financiare dhe sekuestrimet e përkohshme*

Shtojca 1 e Planit të Veprimit 2014-2018¹⁶ përcakton objektivat e hetimeve paraprake të krimeve financiare. Ato përfshijnë indikatorët kyç të performancës për Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës në lidhje me numrin minimal të hetimeve të filluara, ku vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi është 5,000 Euro ose më tepër, vlera neto e pronës e cila është objekt i masave të përkohshme të sekuestrimit, numri minimal i hetimeve të krimeve financiare (vlera e produkteve të krimit 5,000 Euro ose më shumë), të cilat janë të përfunduara dhe të proceduara për shqyrtimin e akuzave si dhe koha mesatare për hetimin e krimeve financiare.

Rezultatet në lidhje me numrin e hetimeve të filluara në krimet financiare kanë qenë si në vijim:

¹⁶Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018.

Tabela 9: Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, Janar-Dhjetor 2015

Hetimet e filluara te krimeve financiare	2015											
	Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Policia	151	166	168	168	166	149	181	129	166	218	182	175
Dogana	3	9	12	13	9	20	5	3	4	6	5	6
Administrata	1	0	7	4	3	0	18	5	3	4	1	10
Gjithesej	155	175	187	185	178	169	204	137	173	228	188	191
Hetimet e filluara te krimeve financiare	2014											
	Jan	Shkurt	mars	prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Stator	Tetor	Nent	Dhjetor
Policia	358	267	272	241	239	241	180	228	199	197	159	203
Dogana	12	10	26	12	11	9	2	5	7	3	2	5
Administrata	3	2	4	0	4	3	2	0	3	1	3	0
Gjithesej	373	279	302	253	254	253	184	233	209	201	164	208

Burimi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2015

Analiza statistikore tregon se nuk ka ndryshime substanciale në lidhje me numrin e përgjithshëm dhe llojet më të zakonshme të krimeve financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës në periudhën janar-dhjetor 2015 në krahasim me vitin 2014. Krimet tipike financiare të pranuar gjatë hetimit paraprak¹⁷ ishin:

- Falsifikimi i valutave;
- Mashtrimet;
- Zaptimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme; dhe
- Kontrabandimi i mallrave.

Mund të konkludohet se autoritetet e zbatimit të ligjit kanë filluar të përqendrohen në veprat më serioze gjatë zbulimit të krimeve financiare.

Informatat në dispozicion në lidhje me numrin e krimeve financiare të proceduara për shqyrtimin e akuzave janë përcaktuar në tabelën më poshtë:

¹⁷Krimet financiare të evidentuara nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2014; dhe Sekretariati.

Tabela 10: Krimet financiare të proceduara për ngritje të padive nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore, Janar-Dhjetor 2015, dhe Janar-Dhjetor 2014

Hetimet e përmbyllura për krimet financiare të proceduara për ngritje të padive	2015												Totali
	Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
Policia	44	71	60	55	56	82	92	84	105	100	78	66	893
Dogana	1	1	10	7	9	4	2	10	1	2	9	7	63
Administrata Tatimore	0	0	3	0	1	2	0	2	1	0	2	0	11
Gjithsej	45	72	73	62	66	88	94	96	107	102	89	73	967
Hetimet e përmbyllura për krimet financiare të proceduara për ngritje të padive	2014												Totali
	Jan	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
Policia	26	20	21	35	25	29	23	55	32	88	30	70	454
Dogana	3	6	12	15	11	9	1	2	6	4	1	4	74
Administrata Tatimore	0	1	2	1	1	3	1	1	1	1	0	1	13
Gjithsej	29	27	35	51	37	41	25	58	39	93	31	75	541

Burimi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2015

Gjurmimi i pasurive është një pjesë thelbësore e procedurës penale lidhur me krimet financiare. Rrjedhimisht, Plani i veprimit 2014-2018¹⁸ përcakton objektivat për fazën e hetimit paraprak në lidhje me masat e përkohshme të sekuestrimit. Rezultatet për vitin 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Tabela 11: Vlera neto e pasurisë së sekuestruar në hetim të Policisë së Kosovës, Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore, janar-dhjetor 2015 dhe janar-dhjetor 2014.

Vlera neto e pasurisë së sekuestruar perkohesisht	2015												
	Jan	Shkur	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Policia	25,960	205,326	97,383	772,076	50,704	2,585,247	1,296,867	1,390,523	1,099,644	5,700	397,120	253,011	8,179,561
Dogana	261	14,130	5,380	23,774	349,811	91,432	31,389	22,389	-	15,145	16,178	-	569,889
e Kosoves	-	-	-	-	13,779.7	-	-	-	-	-	-	-	13,780
Gjithësejt	26,221	219,456	102,763	795,850	414,295	2,676,679	1,328,256	1,412,912	1,099,644	20,845	413,298	253,011	8,763,230
Vlera neto e pasurisë së sekuestruar perkohesisht	2014												
	Jan	Shkur	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Policia	11,100	76,914	22,193	-	300,000	-	-	-	234,659	78,838	1,180	23,136	637,813
Dogana	8,901	9,055	-	121,202	10,000	-	-	20,823	154,869	7,043	-	55,030	368,966
e Kosoves	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithësejt	20,001	85,969	22,193	121,202	310,000	-	-	20,823	389,528	85,881	1,180	78,166	1,006,779

Burimi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, 2015

¹⁸Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018.

Në vitin 2015, shuma e përgjithshme e pasurisë së sekuestruar përkohësisht sipas Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar ishte 1,934,299.65 EUR. Rezultatet e organeve të rendit për vitin 2015 kanë tejkaluar indikatorët e performancës në ndërmarrjen e masave për sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë ku vlera totale arrin në 8,763,229 EUR, gjithashtu duke shënuar rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2014 ku vlera totale për sekuestrim ishte 1,006,779 EUR.

4.4.3.3. Marrja në konsideratë e aktakuzave për krime financiare dhe sekuestrime të përkohshme

Objektivat për fazën e prokurorisë sa i përket krimeve financiare janë identifikuar në Shtojcën 1 të Planit të veprimit 2014-2018. Ato përfshijnë indikatorët kyç të performancës për prokurorët e shtetit në lidhje me numrin minimal të aktakuzave (vlera e të ardhurave nga krimi është 5,000 Euro ose më shumë për krim), koha mesatare e përdorur për shqyrtimin e aktakuzave për krimin financiar, vlera minimale neto e pasurisë e cila është objekt i masave të përkohshme të sekuestrimit dhe vlera minimale totale e kërkesave për konfiskim të përfshira në aktakuzë.

Nuk ka në dispozicion informata të plota dhe të besueshme për rezultatet operative të prokurorëve të shtetit. Statistikat të cilat i janë dorëzuar Ministrisë së Financave dhe Koordinatorit kombëtar për krime ekonomike lidhur me objektivat e fazës së prokurorisë në Shtojcën 1 të Plan Veprimit 2014-2018 nuk janë në përputhje, si dhe në disa raste është evidentuar që nuk ekzistojnë statistikatat fare.

4.4.3.4 Dënimet për krime financiare dhe aktgjykimet për konfiskim

Shtojca 1 e Planit të veprimit 2014-2018¹⁹ përcakton objektivat për procedurat gjyqësore në lidhje me krimet financiare. Ato përfshijnë indikatorët kyç të performancës për Gjykatat themelore në lidhje me numrin e përgjithshëm minimal të vendimeve në lidhje me krimet financiare në të cilat vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi është 5,000 Euro ose më shumë, koha mesatare e përdorur për procedurën gjyqësore për vit kalendarik përkritazi me krimet financiare dhe vlera e përgjithshme minimale totale e vendimeve të shqiptuara për konfiskim.

Sekretariati i udhëhequr nga Ministria e Financave ka siguruar informatat lidhur me numrin e përgjithshëm të dënimeve që kanë të bëjnë me krimet financiare, dhe rezultatet për vitin 2015 janë si më poshtë:

Tabela 12: Dënimet për krime financiare të shqiptuara nga Gjykatat Themelore, Janar- Dhjetor 2015

Dënimet për krime financiare	2014	2015
Gjykatat Themelore	1 756	3 489

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2015

Në vitin 2014, numri i përgjithshëm i dënimeve për krime financiare ishte 1,756, ndërsa në vitin 2015 kjo shifër arriti në 3 489 raste. Mund të konkludohet se produktiviteti i Gjykatave themelore është rritur në vitin

¹⁹Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018.

2015 për 1 733 raste. Megjithatë, kjo shifër prej 3 489 raste përfshin gjithashtu zgjidhjen e rasteve të akumuluar nga vitete paraprake. Analiza statistikore tregon se ka disa ndryshime në lidhje me llojet e krimeve më të zakonshme financiare të përcaktuara në dënimet e shqiptuara nga Gjykatat themelore në periudhën janar- dhjetor 2014 në krahasim në vitin 2013. Krimet tipike financiare të pranuar gjatë procedurave gjyqësore²⁰ ishin:

- Abuzimi me pozitë zyrtare;
- Kontrabandimi i mallrave;
- Kundërvajtje tatimore;
- Zaptimi i paligjshëm i pronës së patundshme; dhe
- Ryshfeti.

Për parandalimin e krimeve financiare është thelbësore që të konfiskohen të ardhurat që rezultojnë nga krimi financiar. Megjithatë, informatat në lidhje me përdorimin e kësaj mase ligjore nuk janë në dispozicion siç edhe mund të shihet më poshtë.

Tabela 13: Vlera totale e vendimeve për konfiskim nga Gjykatat Themelore, janar- dhjetor 2015

Vlera totale e vendimeve për konfiskim	2014	2015
Gjykatat themelore	N/A	N/A

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2015

Aktualisht, funksionimi i mekanizmit për konfiskime është e vështirë të vlerësohet, ku burimet e vetme për statistikë përkatëse janë autoritetet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe Agjencia për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar. Do të ishte e rëndësishme për Qeverinë dhe autoritetet operative të marrin informata në lidhje me vlerën totale të vendimeve për konfiskim. Kjo do t'i ndihmojë ata në vlerësimin e efikasitetit të zinxhirit të procesit në tërësi duke filluar nga gjurmimi i pasurisë e deri te ekzekutimi i vendimeve për konfiskim.

4.4.3.4. Menaxhimi i pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

Agjencia për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar mban statistika lidhur me vlerën neto të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar përkohësisht. Rezultatet kanë qenë si në vijim:

²⁰Statistikat vjetore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2015.

Tabela 14: Vlera e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar nën menaxhimin e Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, janar-dhjetor 2015

Masat ligjore të ndërmarrta kundër të ardhurave nga krimi	2015												Totali
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtat	Teto	Nent	Dhjet	
sekuestrim	840	144,934	31,906	4,841	554	201,359	23,576	11,050	2,960	26,200	36,636	328,455	813,309
konfiskim	-	46,809	21,420	4,708	20,981	6,930	921	8,481	20	26,867	21,196	10,981	169,313
	2014												
Masat ligjore të ndërmarrta kundër të ardhurave nga krimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtat	Teto	Nent	Dhjet	Totali
sekuestrim	56,207	65,891	20,000	60,229	23,931	33,000	30,221	26,309	2,335,271	61,541	20,007,925	845,619	23,566,143
konfiskim	19466	0	824	1805	170	0	0	500	2565	0	1022	0	26,352.00

Burimi: Agjencia për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, 2015

Sipas Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, shuma e përgjithshme e pasurisë së sekuestruar përkohësisht në vitin 2014 kapte vlerën prej 23,566,143 EUR dhe vlera e të ardhurave të konfiskuara të krimit ishte 26 352 EUR. Rezultatet për vitin 2015 tregojnë për një ngritje të pasurive të konfiskuara në krahasim me vitin 2014, ku vlera e pasurisë së konfiskuar në këtë vit ishte rreth 169,313 EUR, ndërsa ajo e sekuestruar ishte 813,309 EUR. Megjithatë, në vitin 2015 shihet një rënie e vlerës së sekuestruar në krahasim me vitin 2014 (shih tabelën 14).

Mund të konstatohet gjithashtu, se statistikat e Agjencisë për Menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar për vitin 2015 në lidhje me vlerën e pasurisë së sekuestruar përkohësisht nuk janë në përputhje me informatat e ofruara nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët. Arsyet për dallime në këto statistika duhet të vlerësohen dhe aplikimi i ligjit nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore duhet të rritet për të siguruar një menaxhim efektiv të pasurisë së sekuestruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, janë ndërmarrë veprime që janë në proces dhe që kanë të bëjnë me ligjin për pastrimin e parave i cili ka kaluar fazën e hartimit të koncept dokumentit. Ligji në fjalë pritet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe njëherit pritet të aprovohet gjatë vitit 2016.

4.4.4. Gjetjet

Sekretariati ka analizuar rezultatet operative në parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurat penale për krimet financiare gjatë periudhës janar-dhjetor 2015. Në vijim janë paraqitur gjetjet e hasura në bazë të informatave të mbledhura nga institucionet përkatëse:

- Shuma e të hyrave buxhetore bruto të mbledhura është 1,492.5 miliard euro duke shënuar një rritje prej 9.2% në të ardhurat e përgjithshme të grumbulluara përgjatë vitit 2015 në krahasim me vitin 2014;
- Shuma totale e mbledhjes së detyrueshme të tatimeve dhe taksave doganore të vonuara ka qenë 21,838,558.73 milion euro;
- NjIF-K ka pranuar 617,430 Raporte për transaksione në para të gatshme (RTG) dhe 372 Raporte për transaksione të dyshimta (RTD). Njësia ka shpërndarë gjithsej 94 raporte te inteligjencës së

autoriteteve të mandatuara që nënkupton se numri total ka arritur objektivat e caktuara në indikatorët kyç të performancës.

- Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë evidentuar gjithsej 2,170 krime financiare duke shënuar rënie në krahasim me vitin 2014.
- Krimet më të zakonshme financiare të evidentuara nga autoritetet e zbatimit të ligjit kanë pas të bëjnë me falsifikime të valutave, mashtrime, zaptime të paligjshme të pasurisë së patundshme dhe kontrabandë të mallrave;
- Vlera totale e pasurisë së sekuestruar përkohësisht nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës ka qenë 8,763,230 Euro;
- Një informacion i plotë dhe i besueshëm për rezultatet operative për sa i përket objektivave për fazën e prokurorisë të përcaktuar në Aneksin 1 të Planit të Veprimit 2014-2018 nuk është në dispozicion
- Numri i përgjithshëm i dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat themelore për krime financiare ishte 3,489, që shënoj rritje në krahasim me vitin 2014.
- Krimet më të zakonshme financiare të përcaktuara në dënimet e shqiptuara nga Gjykatat themelore kanë qenë shpërdorimi i pozitës zyrtare, kontrabanda e mallrave, kundërvajtjet tatimore, zaptimi i paligjshëm i pasurisë së patundshme dhe ryshfeti;
- Vlera totale e vendimeve të Gjykatave themelore për konfiskim nuk është në dispozicion;
- Vlera totale e pasurisë së sekuestruar përkohësisht, e që gjendet nën menaxhimin e Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar për vitin 2015 arriti në vlerë prej 813,309 euro.
- Vlera totale e pasurisë së konfiskuara përkohësisht, e që gjendet nën menaxhimin e Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, ka qenë 169,313 euro;
- Statistikat e 2015-të të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorëve në lidhje me vlerën e pasurisë së sekuestruar përkohësisht nuk janë në përputhje me informacionin e Agjencisë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Në lidhje me mbikëqyrjen e implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018 dhe menaxhimin e performancës në lidhje me procedurën penale për krimet financiare, fazat më sfiduese janë prokuroria dhe përdorimi i vendimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim. Kjo është rezultat i informatave jo të plota dhe jo konsistente.

5. KONKLuzionet dhe Rekomandimet në Lidhje me Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit si dhe Krimeve Ekonomike dhe Financiare

5.1. Implementimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018

5.1.1. Konkluzionet dhe rekomandimet

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet përgjegjëse të sektorit publik, privat dhe të tretë kanë filluar implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018. Aktivitetet janë kryesisht në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këto dokumente të politikave. Megjithatë, ka krejt tre (3) rreziqe të cilat mund të menaxhohen bazuar në masat e nivelit kombëtar. Ato janë të lidhura me zbatimin e objektivit strategjik "Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse".

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të rrit implementimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018, efikasitetin dhe transparencën e parandalimit të ekonomisë joformale dhe krimeve financiare dhe të ndërgjegjësimit, aftësitë dhe kapacitetet e institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë në lidhje me luftën kundër këtyre dukurive të dëmshme. Prandaj rekomandohet që Qeveria të siguroj që:

1. Autoritetet përgjegjëse dhe të përcaktuara të vazhdojnë të ofrojnë informacionet e kërkuara tek Sekretariatit, në baza 3 mujore, në lidhje me punën e tyre operative dhe rezultatet e përcaktuara në Shtojcën 1 të aktivitetit 2.4.1 të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Kjo masë është e nevojshme për ta rritur efikasitetin dhe transparencën e parandalimit të ekonomisë joformale dhe krimit financiar dhe për të siguruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018;
2. Alokimi i buxhetit për Policinë e Kosovës për implementimin e aktivitetit (2.4.3) për të mundësuar krijimin, implementimin dhe vlerësimin e programit trajnues nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me NJIF-K dhe institucionet tjera të angazhuara në parandalimin e pastrimit të parave, financim të terrorizmit dhe krimeve financiare. Kjo masë është e nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin, aftësitë dhe kapacitetet e institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar dhe për të siguruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.
3. Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal të e Kosovës për të përfshirë edhe penalizimin e një kundërvajtje të kontabilitetit, sepse përcaktimet në lidhje me veprat penale të kontabilitetit janë shumë të përgjithshme. Në Kodin Penal duhet të jetë një nen specifik në bazë të cilit një person me një detyrim ligjor për të mbajtur llogaritë, përfaqësuesi i tij ose të saj, personi i cili ushtron autoritet aktual vendimmarrës në një shoqëri me një detyrim ligjor për të mbajtur libra, ose personi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit/llogarive.

5.2. Performanca operative

5.2.1. Konkluzionet dhe rekomandimet

Shtojca 1 i aktivitetit 2.4.1 të Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përcakton objektivat dhe indikatorët kyç të performancës për institucionet përgjegjëse administrative, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Procesi i zbatimit të këtyre masave ka nisur dhe rezultatet e para janë premtuese. Megjithatë, ka disa faza të caktuara të cënueshme në zinxhirin e procesit për shkak të informatave jo të plota dhe jo konsistente mbi performancën. Kjo posaçërisht ka të bëjë me ndjekjen penale dhe përdorimin e aktgjykimeve për sekuestrim të përkohshëm dhe konfiskim. Rrjedhimisht, mekanizmat e menaxhimit të performancës së institucioneve relevante duhet të zhvillohen dhe gjenerimi dhe shpërndarja e informatave të nevojshme për vlerësimin e performancës së tyre duhet të sigurohet dhe rregullohet për ta rritur efikasitetin dhe transparencën e proceseve.

Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të rrisë efektivitetin dhe transparencën e parandalimit të ekonomisë joformale dhe krimit financiar duke siguruar që:

1. Buxheti i Qeverisë për vitin financiar 2016 e tutje të përfshijë objektivat e nivelit kombëtar në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurat penale për krimet financiare për institucionet përgjegjëse administrative, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësore; dhe
2. Institucionet përgjegjëse administrative, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësore për parandalimin e ekonomisë joformale dhe për procedurën penale për krimet financiare të përgatisin plane të performancës për vitin financiar 2016 dhe tutje. Këto plane duhet të përfshijnë objektiva të sakta në nivel institucional, masat për implementimin e tyre si dhe indikatorët kyç të performancës në lidhje me parandalimin e ekonomisë joformale dhe procedurën penale të krimeve financiare. Objektivat e planeve të performancës në nivel institucional duhet të derivojnë nga qëllimet e buxhetit të Qeverisë dhe për këtë arsye hartimi i tyre duhet të fillojë njëkohësisht me buxhetin qeveritar për vitin financiar 2016 e tutje.